

Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

Domosdoshmëria**për të adresuar Ligjin për Referendumet****dhe mekanizma të tjerë të demokracisë së drejtpërdrejtë në Shqipëri**

Qysh prej vitit 1991 dhe rënies së sistemit komunist, në Shqipëri janë zhvilluar 18 procese zgjedhore të përgjithshme, tre prej të cilëve kanë qenë procese për referendum dhe dy zgjedhje parlamentare të parakohshme.

Ndonëse statistikisht e proceseve zgjedhore në 25 vitet e fundit japin pamjen e një shteti me vullm vendimmarrje demokratike të konsiderueshme, sot realiteti flet për të kundërtën.

Pavarësisht përmirësimeve të qenësishme, raportet ndërkombëtare e vendase të vëzhgimit për këto procese zgjedhore, përsërisin problematika të rënda të mbarëvajtjes së tyre dhe të shprehjes së vullnetit demokratik të pacenuar.

Prej një viti, në Shqipëri ka nisur një proces ridimensionimi kushtetues, thelbësor në funksion të luftës kundër korrupsionit dhe vitalizimit të sistemit të drejtësisë, objektiva kryesorë këto të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit.

Pjesë e kësaj strategjie është edhe reformimi i kuadrit ligjor për procesin zgjedhor, për të cilin është ngritur që në muajin janar 2016 edhe një Komision i Posaçëm Parlamentar. Në objektivin e Komisionit ashtu siç është afirmuar në vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për ngritjen e tij, por edhe në qëndrimet e përfaqësuesve më të lartë politikë, priten të jenë rekomandimet e Raporteve Përfundimtarë të OSBE/ODIHR-it për proceset zgjedhore të vitit 2013 dhe 2015.

Në qëndrimin e advokuar prej organizatës KRIIK, si pjesë dhe së bashku me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë (KVV), është konsideruar se çfarëdolloj shmangie apo deformimi i vullnetit popullor përbën shfaqje të korrupsionit zgjedhor.

Shkaktarë për këtë lloj korrupsioni mund të jenë: keqadministrimi i procesit zgjedhor; mos transparenca dhe mos rregullimi i financave të partive politike; mos dhënia e drejtësisë në proceset ankimore me objekt procesin zgjedhor; mos sanksionimi i shkeljeve të kuadrit ligjor zgjedhor; apo edhe vetë sistemi i përfaqësimit politik jo i drejtë dhe i saktë në pasqyrimin e vullnetit popullor.

Shfaqje që, siç e dëshmojnë dhe e kanë faktuar raportet e organizmave vendase dhe të huaja, përvoja demokratike e proceseve zgjedhore në Shqipëri i ka kaluar në masë të gjerë dhe po vuan ende pa u ndarë dot prej tyre.

Në këtë frymë, KRIIK, së bashku me Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë, organizuan në janar të vitit 2016 Konferencën Kombëtarë me temë "Korrupsioni Elektorale; Nevoja për një reformë elektorale të thelluar dhe gjithëpërfshirëse".



në bashkëpunim me / in collaboration with:

Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë

Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

Aktivitetet ku ishin ligjërues në të njëjtin sesion, për herë të parë në tërë historikun e demokracisë shqiptare, tre liderët politikë kryesorë në vend, së bashku me tre ambasadorët e përfaqësive më të rëndësishme në vend. Prej folësve u shpreh në unison angazhimi politik, jo vetëm në Reformën Zgjedhore, por edhe për një qasje në ritheksim të respektimit të vullnetit popullor.

Një instrument i fuqishëm dhe garanci kushtetuese e patjetërsueshme e vullnetit popullor është **konsulta popullore, e cila është e afirmuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Megjithatë, që prej Referendumit të mbajtur për miratimin e Kushtetutës, nuk është arritur të zhvillohet asnjë referendum i dytë. Ndonëse ka patur disa nisma, prej qytetarëve apo prej subjekteve të tjera, për referendume abrogues dhe legjislativë, ato nuk janë konkluduar, për arsye të ndryshme. Kjo, më së shumti, për shkak të një kuadri ligjor mbi referendumet me mangësi të forta.

Kuadri ligjor i sotëm për konsultat referendare është pa një identitet parimor dhe në frymë përsa i përket qasjes juridiko-politike të ligjvënësit në raport me këtë institut ligjor të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Në parim, afirmohen të gjitha format e konsultave referendare, por, për nga natyra procedurale që vendosen, ato gati pamundësohen. Kjo edhe për shkak të një mungese vizioni në hartimin e Kushtetutës, i cili është agravuar më shumë në kohë nga amendimet dhe ndërhyrjet kushtetuese të bëra, si edhe të kuadrit ligjor përsa i përket sistemit zgjedhor.

Nevoja emergjente e adresimit të kuadrit ligjor për çështjet referendare është një shqetësim i hershëm i shoqërisë civile, i shprehur sidomos në tre vitet e fundit. Këtu përfshihen jo vetëm organizatat me interes dhe angazhim të drejtpërdrejtë në çështjet zgjedhore, por edhe të tjerë aktorë të shoqërisë civile, si dhe aktorë të ndryshëm politikë.

KRIIK dhe Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë kanë qenë prej atyre që e kanë artikulluar në vijimësi këtë shqetësim dhe vazhdojnë të vënë theksin për këtë domosdoshmëri.

Prej kohësh, në këtë drejtim po zhvillohen një seri takimesh dhe është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me përfaqësues të forcave politike parlamentare dhe ato jo parlamentare. Në këto takime, në vazhden e shqetësimeve dhe problematikave të tjera të përcjella, përfaqësuesve politikë iu është parashtruar edhe çështja e demokracisë së drejtpërdrejtë, dhe më konkretisht ajo e referendumeve. Shqetësim që ka marrë në tërësi dakordësinë e përfaqësuesve politikë dhe mbështetjen e tyre për adresimin e mëtejshëm.

Boshllëku ligjor, nismat qytetare të disahershme por të pafinalizuara, advokimi i shumëkohshëm i organizatave të shoqërisë civile dhe dakordësia e afirmuar politike, përbëjnë një amalgamë faktorësh shtysë që duhet të materializojnë një Akt ligjor për nismat popullore.



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

Një akt më shumë se procedural, që së pari duhet të adresojë kontekstin e problematikave të demokracisë së drejtpërdrejtë me të cilat përballet vendi. Nga ana tjetër, dhe më e rëndësishmja, ky akt të jetë një pikënisje e një fryme publike dhe politike e rritjes së mundësive dhe mekanizmave që sigurojnë pohimin e vullnetit popullor në vendimmarrje, sidomos përsa i përket qeverisjes dhe hartimit të politikave në nivel vendor.

Momenti politik, si vit zgjedhor për Qeverinë Qendrore të vitit 2017 (zgjedhje parlamentare), është mundësi shumë e mirë për të ushtruar presionin e duhur për të bërë të mundur vënien në axhendat dhe në platformat politike të subjekteve elektorale domosdoshmërinë e miratimit të Ligjit "Për Referendumet" në çastin më të parë post-elektoral, si edhe të mekanizmave të tjerë që sigurojnë hapjen e proceseve vendimmarrëse. Gjithashtu, synohet që akti për Referendumet dhe mekanizmat e tjera mbi demokracinë e drejtpërdrejtë të jetë objekt i punës së një Komisioni Parlamentar të Posaçëm, një produkt i një procesi konsultimi të gjerë paraprak si edhe e një informimi masiv pas miratimit.

Në këtë kontekst, KRIIK dhe Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë po ndërmarrin organizimin e një Konferencë Ndërkombëtare dy ditore në datat 2-3 Shkurt 2017.

Ky aktivitet parashikohet të ketë pjesëmarrjen e gjithë aktorëve vendas me interes dhe peshë në nismat referendare, si dhe pjesëmarrjen e një ekspertize të lartë ndërkombëtare. Kjo përballje në pjesëmarrje ka për qëllim ngritjen e një diskutimi të gjithanshëm të problematikave apo traditës vendase me përvojat më të mira ndërkombëtare.

Prioriteti i Konferencës është imponimi i diskutimit të hapjes së proceseve vendimmarrëse dhe politikëbërëse, institucionale dhe partiake ndaj vullnetit popullor. Ndër të tjera, materializimi i kësaj qasje në hartimin e një Ligji "Për Referendumet" jo si një akt procedural i thjeshtë, por si adresimi i një sfide madhore, siç është demokracia e drejtpërdrejtë, e cila nuk është sfidë lokaliste vetëm e vendit tonë.

Konferenca parashikohet të jetë e ndarë në gjashtë seksione diskutantësh, ku pesë do të zhvillohen ditën e parë dhe seksioni i gjashtë do të mbahet në ditën e dytë.

Pesë seksionet e para kanë për qëllim vendosjen e dimensioneve të diskutimit që është dhe qëllimi parësor i Konferencës.

Temat e seksioneve do të jenë:

- "Demokracia shqiptare, tranzicioni dhe detyrimet në një demokraci të konsoliduar";
- "Konteksti shqiptar – eksperiencia dhe perspektiva";



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

- “Shfaqjet e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe format alternative. Demokracia përfaqësuese dhe demokracia e drejtpërdrejtë – Konteksti ndërkombëtar”;
- “Perspektivat dhe qendrimet e partive politike në Shqipëri” dhe
- “Roli i aktorëve civilë dhe pjesëmarrja në proceset institucionale dhe qeverisëse”.

Në seksionin e gjashtë, parashikohet publikimi i konkluzioneve paraprahe të dokumentit përmbledhës mbi bazën e diskutimeve gjatë pesë sesioneve të para, si edhe paraqitja e qëndrimeve të drejtuesve politikë pjesëmarrës në këtë seksion të Konferencës, për vënien në axhendën e platformave politike të subjekteve të tyre elektorale domosdoshmërinë e miratimit të Ligjit “Për Referendumet” dhe të mekanizmave të tjera për demokracinë direkte në çastin më të parë post-elektoral.

Tiranë, Janar 2017



në bashkëpunim me / in collaboration with:



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë**

